



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-klina.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



KOMUNA KLINA

ZYRA E PROKURIMIT

01 NR. 351-5300/18

DATE 07.08.2018

KONTRATA NR.059/2018

Komuna Kline, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), që përfaqësohet nga **Z.Abaz Foniqi** – menaxher i z. Prokurimit në njërin anë; dhe

"N.N" SHQPERONI " –nga KLINA (në vazhdim "Kontraktuesi"), "me numer biznesi **80000057** dhe numer fiskal **600260525** . ME PRONAR **Z. JANUZ MORINA** ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për pune e shënuara me poshtë:

NDERTIMI I FUSHAVE TE SPORTIT DHE RRETHOJAVE NE SHKOLLAT "

LOT 1- NE SHFMU KPUZ, LOT 2- SHFMU PERQEVE

me numër identifikues: 634-18-4338-521/634-18-058-521

Neni 1 **Lënda**

Lënda e kontrates është :PUNE - sipas paramanave te dhena ne Oferte

Neni 2 **Çmimi**

2.1 Çmimi total i punëve është:

49.976.25 € (Dyzetenenemijeneneteqindeshatedhjetegjashteeuroe25/100 eeuro)

2.2. Vlera e kontrates Sipas Planit Dinamik është 60 dite pune. .

2.3. Kontrata do te jete kontrate publike per Njesis per PUNE -.

2.4. Garancioni i Kontrates ne vlere 4.897.63 € me validitet 60+30= 90 dite kalendarik.

2.4. **Plani per implementim programi do te jete Sipas Porosive nga Menaxheri i Kontrates**



2.5 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës. -sipas situacioneve dhe perfundimit të shërbimeve sipas planit dinamik me raport nga menaxheri i projektit, raport pranimi dhe raportin detal të menaxhimit të kontratës - pas perfundimit të shërbimeve

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
 - (b) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- 3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

4.5. Per menaxhim te kontrates bazuar ne nenin 81 te LPP 04/L-42 emerohet me vendim te ZKA -kryetarit nga Drejtoria e DKA ,me vendim.

Për Autoritetin Kontraktues
Komuna Kline

Për Kontraktuesin
N. N. " SHQIPRONI - KLINE

Emri:	Abaz Foniqi		
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	I Autorizuar	BESAR MORINA
Nënshkrimi:			
Data:	07.09.2018		
Vula:			

PJESA II E KONTRATËS KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1

Përkufizimet

- 1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.
- 1.2 "Shërbimet" do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 1.3 "Ofrues i shërbimeve" është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.
- 1.4 "Personeli" do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.
- 1.5 "Çmimi i kontratës" do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.
- 1.6 "Nënkontraktuesi" do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.
- 1.7 "Palë" nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.
- 1.8 "Autoriteti Kontraktues" nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.
- 1.9 "KPK" nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- 1.10 "KVK" nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2

Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

- 2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.
- 2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3

Transferimi

- 3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.
- 3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, sipas kontratës; ose
- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguresve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

- 4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një palë të tretë.
- 4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmerisë.
- 4.3 Autoriteti kontraktues nuk njezh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5

Tatimi

- 5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.
- 5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.
- 5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit të shërbimeve.
- 5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

Neni 6

Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

- 6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrimit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.
- 6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteteve.

Neni 7

Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

- 7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:
- dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;
 - forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8

Forca Madhore

- 8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkakuar nga një forcë madhore që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.
- 8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.
- 8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjeluar paafësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.
- 8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.
- 8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmëroj palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizoj obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

- 9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10

Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paafët të kryejë një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11

Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofruesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrin. Ekzekutimi i urdhrin administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuar në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.

Neni 12

Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13

Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilin ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbrësë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet ti behen Ofruesit të Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emër të vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:

- konfiskojë garancinë e performancës;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emër të vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emër të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bërë porosinë anulon porosinë dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emer të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofruesi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni 15

Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se prirret e tanishme janë paguar.

Neni 16

Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës se leshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emer të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Neni 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17

Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësi të ofruesit të shërbimeve. Autoriteti kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç është definuar në KVK.

Neni 18

Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19

Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

a) dëmet; dhe/apo

b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

a) dëme të përgjithshme; ose

b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20

Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arrijen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përipiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

a) vendim nga gjyqi; ose

b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jete përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, dëmet, dhe pagesat e shikaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë aseti të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë

1. PJESA III E KONTRATËS kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Kline .
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë SHQIPE
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është : <i>Nga DKA me vendim te ZKA</i>
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është 10 % NGA VLERA E KONTRATES PER PERIUDHEN 60+30=90 dite Perkatesisht vlere 4.897.63 €.
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Rreziqet dhe mbulesat nga sigurimi do të jenë: a) Mjetet motorike të Palës së Tretë 100 % nga Punekryesi b) Përgjegjësia e pales së tretë 100 % nga punekryesi c) Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve Pergjegjesi e punekryesit d) Përgjegjësia profesionale e O.E. e) Humbje ose dëmtim të pronës dhe pergjegjesi e o.e.
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Punet –Shërbimet duhet te jene ne cilesi dhe sakesi simbas specifikacionit te produkteve te perdorura dhe cilesis se punimeve conform ofertes . Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: aty per aty Periudha e përgjegjësise së Defekteve është gjate tere afatit te Implementimit te projektit: 12 muaj pas pranimit te puneve
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	<i>Specifikoni departamentin e Komisionit përgjegjës për pajtim]</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>[specifikoni gjykatën kompetente]</i> në pajtim me ligjin në

gjqësore	<p>Kosovë.</p> <p>ose</p> <p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të në pajtim me <i>specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].</i></p>
----------	--

2. PJESA IV E KONTRATËS: MODEL I SIGURISË SË EKZEKUTIMIT

[Me logon e institucionit financiar që e jep sigurinë]

Për: **KUVENDI KOMUNAL I KLINËS**
(në vazhdim: "autoriteti kontraktues")

Në emër të: **NN" SHQIPRONI Kline**
(në vazhdim "operatori ekonomik")

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **FUSHAT E PORTIT DHE RRETHOJAT N SHKOLLAT KPUZ DHE PERQEVE**

Numri i Prokurimit: **634-18-4338-5-2-1**

Garancion me kërkesë të pare

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit , me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **4.897.63€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substancionale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbetur pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe /ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **4.897.63 €** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

Kjo siguri vlen deri me: 60+30= 90 DITE

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesve

Emri i institucionit financiar

Adresa

Data

NDËRTIMI I FUSHËS SPORTIVE NË FSHATIN KËPUZ

L=42.2m', B=22.2m'

NR.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njësi (€)	Shuma (€)
1	PUNËT PËRGATITORE				
1.1	Bartja e elementeve të trasës dhe matjet gjeodezike gjatë zhvillimit të punimeve .	m ²	989	0.3	296.70
GJITHSEJTI:					296.70

NR.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi (€)	Shuma (€)
2	PUNËT E GËRMIMIT				
2.1	Gërmimi i dheut T=30cm për zgjerimin e bazeve të fushës së futbollit, dhe transporti deri në deponi, apo deri në vendin ku e cakton organi mbikqyres, largësi 5km	m ³	296.7	1.50	445.05
2.2	Nivelizimi, ngjeshja (kompaktimi) i nënbazës me cilindër vibrues me peshë 12t.	m ²	989	0.50	494.50
GJITHSEJTI:					939.55

NR.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi (€)	Shuma (€)
3	SUPERSTRUKTURA (PJESA E SIPËRME E FUSHËS)				
3.1	Furnizimi, transporti vendosja dhe ngjeshja e shtresës stabilizuese me gurë natyror (koherent) me t=50cm në gjendje të ngjeshur.	m ³	494.5	4.80	2,373.60
3.2	Furnizimi, transporti, vendosja dhe ngjeshja e shtresës stabilizuese me material guror që i plotëson kushtet e parapara për tampon, fraksion 0-63mm, me trashësi t=20cm	m ³	197.8	7.00	1,384.60
3.3	Furnizimi, transporti, vendosja dhe ngjeshja e shtresës së tamponit me material guror, fraksion 0-31.5mm, me trashësi t=10cm, në gjendje të ngjeshur, Ms=700kg/cm ²	m ³	98.9	9.00	890.10
3.4	Punimi i shtresës së bitoagregadit (BA 16), furnizimi, transporti, shtrirja dhe ngjeshja, me trashësi prej t=7cm .	m ²	936.8	9.00	8,431.20
GJITHSEJTI:					13,079.50

SUPERSTRUKTURA (PJESA E SIPËRME E FUSHËS)

(në çmim të përfshihet saldimi, bulonat, ngjyra anti korroduese, ngjyra e gjelber sipas specifikimeve në projekt, skelet, si dhe aksesoret që shërbejnë për dy dyer sipas specifikacioneve në projekt)

F. Luski



nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Totali
1	Pastrimi i terrenit ,rrafshimi dhe bartja e materialit ne deponi	paushall			€
2	Hapja e gropave për vendosjen e shtyllave 0,4x0,4x0,4m ne çdo 2m dhe largimi i dheut	m ³	1	20.00	20.00
3	Betonimi i gropave	m ³	9.72	5.00	48.60
4	Furnizimi dhe vendosja e shtyllave metalike 60x60x2mm ne çdo 2m me lartësi 2.0. Ne llogari te parashihet edhe lyerja me ngjyrë bazë dhe ngjyrë metalike si dhe mbyllja me kapak.	copë	9.72	45.00	437.40
5	Furnizimi dhe punimi i rrethojës nga profilet metalike 40x20x1,5mm.(profilet gjatësore) dhe 25x25x1,50mm (profilet tërthore ne çdo 12 cm)Lartësia e rrethojës 1,70m Ne llogari te parashihet ngjyrosja me ngjyrë bazë dhe ngjyrë metalike si dhe vendosja e kapakëve .	m ²	154	8.00	1,232.00
6	Furnizimi dhe montimi i derës nga profilet metalike 100/170. Ne llogari te parashihet edhe ngjyrosjame ngjyrë bazë dhe ngjyrë metalike	copë	502	9.00	4,518.00
7	Furnizimi dhe montimi i derës nga profilet metalike 400/170. Dera duhet te jetë në shin. Ne llogari te parashihet ngjyrosja me ngjyrë bazë dhe ngjyrë metalike	copë	1	200.00	200.00
	TOTALI		1	400.00	400.00
					6,856.00

RIKAPITULLIM	
1	NDËRTIMI I FUSHËS SPORTIVE NË FSHATIN KËPUZ
2	RRETHOJA KËPUZ
	TOTALI:
	15,375.75
	6,856.00
	22,231.75

Handwritten signature



Handwritten marks

PJESA 1 - FUSHA

NDËRTIMI I FUSHËS SPORTIVE NË FSHATIN PËRÇEVË

L=42.2m', B=22.2m'

NR.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€)	Shuma (€)
1	PUNËT PËRGATITORE				
1.1	Bartja e elementeve të trasës dhe matjet gjeodezike gjatë zhvillimit të punimeve .	m ²	989	0.2	197.80
GJITHSEJT:					197.80

NR.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi (€)	Shuma (€)
2	PUNËT E GËRMIMIT				
2.1	Gërmimi i dheut T=30cm për zgjerimin e bazes së fushes së futbollit, dhe transporti deri në deponi, apo deri në vendin ku e cakton organi mbikqyres, largesi 5km	m ³	296.7	1.20	356.04
2.2	Nivelizimi, ngjeshja (kompaktimi) i nënbazës me cilindër v'brues me peshë 12t.	m ²	989	0.30	296.70
GJITHSEJT:					652.74

NR.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi (€)	Shuma (€)
3	SUPERSTRUKTURA (PJESA E SIPËRME E FUSHËS)				
3.1	Furnizimi ,transporti vendosja dhe ngjeshja e shtreses stabilizuese me gurë natyror (koherent) me t=60cm në gjendje të ngjeshur.	m ³	593.4	4.50	2,670.30
3.2	Furnizimi,transporti,vendosja dhe ngjeshja e shtresës stabilizuese me material guror që i plotëson kushtet e parapara për tampon, fraksion 0-63mm, me trashësi t=20cm	m ³	197.8	7.50	1,483.50
3.3	Furnizimi, transporti, vendosja dhe ngjeshja e shtresës së tamponit me material guror, fraksion 0-31.5mm, me trashësi t=10cm, në gjendje të ngjeshur, Ms=700kg/cm ²	m ³	98.9	8.50	840.65
3.4	Punimi i shtresës së bitoagregadit (BA 16), furnizimi, transporti, shtrirja dhe ngjeshja, me trashësi prej t=7cm .	m ²	936.8	9.00	8,431.20
GJITHSEJT:					13,425.65

SUPERSTRUKTURA (PJESA E SIPËRME E FUSHËS)

(ne cmim te perfshihet saldimi, bulonat, mgjyra anti korriduese, ngjyra e gjelber sipas specifikimeve ne projekt, skelet, si dhe aksesoret qe sherbejn per dy dyer sipas specifikacioneve ne projekt)

F. B. G.



4.1	Punimi dhe montimi i shtyllave për tabela të basketbollit me diametër Ø125mm duke llogaritur edhe përforcimet në bazament me pllaka të hekurit 600 x 600 x 20mm, ankorimin e bulonave Ø20mm gjatësi 80cm vendosjen-saldimin e pllakave përforcuese. Vërejtje: Për shtylla duhet të punohet edhe bazamenti nga betoni i thjeshtë MB20 me dim. 100 x 100 x 80cm duke llogaritur edhe tamponin në bazament me trashësi t=20cm. Krejt sipas skicës së bashkangjitur. Në llogari hyne edhe Blerja dhe montimi i tabelës së basketbollit me dim. 180 x 120cm nga plastika polikarbon (rezistues ndaj kushteve klimatike), duke llogaritur edhe vendosjen e rrethit të basketbollit nga hekuri me gjithë rrjetë.	cope	2	300	600
4.2	Furnizimi me të gjitha materialet e nevojshme, dhe montimi i paisjes sportive të voleibollit e perber nga: dy shtylla nga alumini me dimensione 103*101mm për gara të voleibollit me shtrengues dhe me mundësi të fiksimit të lartesis prej 190cm deri 250cm dhe me matesit e shtyllit tip MASTER. Në llogaritje të përfshihet edhe furnizimi dhe montimi i mbrojtësve të bute për shtylla, dy kapakve të aluminit për shtylla 101*103mm gjatësi 350mm për shtyllë që fiksohen me beton, rrjeta për gara e cila është e fiksuar për shtylla 6 here përmes kabllor me gjatësi 11.7m, rrjeta ka trashësi 4mm, dimensione 80*80mm, dy antena shtrenguesin dhe mbeshtjellsin e rrjetës.	cope	1	300	300
4.3	Kufizimi dhe ngjyrosja e fushës sipas specifikacioneve në projekt, futboll, basketboll, voleiboll	m'	360	1	360
GJIHSEJTI:					1260
TOTAL :					15,536.19

PJESA 2- RRETHOJAT					
nr	Përshkrimi				
1	Pastrimi i terrenit ,rrafshimi dhe bartja e materialit në deponi	paush	1	20.00	20.00
2	Hapja e gropave për vendosjen e shtyllave 0,4x0,4x0,4m në çdo 2m dhe largimi i dheut	m3	12.6	5.00	63.00
3	Betonimi i gropave	m3	12.6	45.00	567.00



Handwritten signature in blue ink.

Handwritten signature in blue ink.

Handwritten checkmarks and scribbles in blue ink.

Handwritten checkmarks in blue ink.

K...
1.
2. / 3.

4	Furnizimi dhe vendosja e shtyllave metalike 60x60x2mm ne çdo 2m me lartësi 2.0. Ne llogari te parashihet edhe lysterja me ngjyrë bazë dhe ngjyrë metalike si dhe mbyllja me kapak.	cope	194	8.00	1,552.00
5	Furnizimi dhe punimi i rrethojës nga profilet metalike 40x20x1,5mm.(profilet gjatësore) dhe 25x25x1,50mm (profilet tërthore ne çdo 12 cm)	m2	638	7.80	4,976.40
6	Lartësia e rrethojës 1,70m Ne llogari te parashihet ngjyrosja me ngjyrë bazë dhe ngjyrë metalike si dhe vendosja e kapakëve .Furnizimi dhe montimi i derës nga profilet metalike 100/170. Ne llogari te parashihet edhe ngjyrosja me ngjyrë bazë dhe ngjyrë metalike	cope	1	180.00	180.00
7	Furnizimi dhe montimi i derës nga profilet metalike 400/170. Dera duhet te jetë në shin. Ne llogari te parashihet ngjyrosja me ngjyrë bazë dhe ngjyrë metalike	cope	1	350.00	350.00
TOTALI					7,708.40

PJESA 3- RRËNIMIMI I OBJEKTIT						
Përshkrimi i objektit për rrënim: Objekti është përdhësë, ka përmasa 24 m x 16.32 m = 391.68 m ² Ballkoni 12.72 m ² Gjithsej 404.4 m ² Themelët janë shiritore me sipërfaqe 404.4 m ² Vlenë të theksohet se objekti është me pllakë. Objekti ka 6 dhoma dhe koridorin prej tyre katër dhoma me përmasa 9mx6.35m Dy dhoma 4mx4m dhe koridorin 23mx2m. Vërejtje: Në rrënim objekti është pa kullm si dhe pa dritare. MAERJALET DO TE HUDHEN NGA PUNEKRYESI NE VDNDIN KU PERCAKTON INESTITORI KOMUNA						
Totali					1	3,500.00
Totali						3,500.00

RIKAPITULLIMI			
1	PJESA 1 - FUSHA		15,536.19
2	PJESA 2- RRETHOJAT		7,708.40
3	PJESA 3- RRËNIMIMI I OBJEKTIT		3,500.00
TOTALI:			26,744.59



REKAPITILLIM LOT 2

- 1. FUSHA..... € 15,536.19
- 2. RRETHOJA..... € 7,708.40
- 3. RRENIMI I OBJEKTIT..... € 3,500.00

TOTALI I LOT 2.. 26,744.59

EMRI I OE:	IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TE OE:	KLINË SHOIPERON
NENSHKRIMI:	JANUZE MORHA
DATA:	08/07/2018
VILA:	OSHTERAJA



Handwritten signature and initials in blue ink.

N.N"SHQIPËRONI" & "WORLD MEDIUM" KLINË - MALISHEVË

PLANI DINAMIK

OBJEKTI:NDERTIMI I FUSHAVE TE SPORTIT DHE RRETHOJAVE
LOT 1- FUSHAT E SPORTIT DHE RRETHOJAT NE KPUZ

JAVET

PËRSHKRIMI I PUNIMEVE

Nr. >> 30 DITË PUNE <<

1 PUNËT E PERGADITORE

2 PUNËT E DHEUT

3 PUNËT E ZHAVORIT

4 PUNËT ASFALTIT

5 PUNËT E RRETHOJES

6 PUNËT TE TJERA

JAVA 1

JAVA 2

JAVA 3

JAVA 4

JAVA 5

JAVA 6

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30
1																														
2																														
3																														
4																														
5																														
6																														

Punimet do të përfundojnë për 30 ditë pune

N.N "SHQIPËRONI" KLINË & "WORLD MEDIUM" MALISHEVË





ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta kenë

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. 68902

Për **KUVENDI KOMUNAL KLINE**

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **NN SHQIPERONI**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **NDERTIMI I FUSHAVE TE SPORTIT DHE RRETHOJAVE LOT 1- FUSHAT E SPORTIT DHE RRETHOJAT NE KPUZ LOT 2- FUSHAT E SPORTIT DHE RRETHOJAT NE PERQEVE**

Nr. prokurimit: 634-18-4338-5-2-1, Nr. brendshëm: 634-18-058-521

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **4,978.00€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **4,978.00€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsye të oshkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë deri më 05.11.2018 ora 11:21:06

Data lëshimit: 07.08.2013

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Nr. Seria: 0027241